



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 624/5 prot.

Tiranë, më 20.12.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besim Hajdarmataj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 5.12.2019, është njoftuar vendimi nr. 200, datë 16.10.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Besim Hajdarmataj, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 4.12.2019, është depozituar akti, “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, është prokuror prej vitit 1999 dhe aktualisht ushtron detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1, e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Besim Hajdarmataj, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Besim Hajdarmataj”, ka referuar:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar për subjektin: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

2.3 GPPP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore, krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi i thellë administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe pas verifikimit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. [...] (f. 12 e vendimit). Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.*

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet

përgjegjëse për përshtatshmërinë e figurës së subjektit, edhe pas kryerjes se hetimit të thelluar, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germës “b”, të ligjit nr. 84/2016.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga GPPP-ja, hetimin dhe vlerësimin e (17) denoncimeve nga publiku, provat dhe shpjegimet e subjektit për të provuar të kundërtën e barrës së provës (për 5 procedime penale) dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, që ka propozuar vlerësimin për subjektin “i aftë”, ndër të tjera, ka konkluduar se: [...] *për katër çështje penale të analizuara nuk rezultuan të dhëna/prova që të provonin se veprimet e drejtuesit ishin të paramenduara, nuk janë të mjaftueshme për ta vlerësuar me mangësi profesionale... dhe, si të tilla, për këto çështje ku subjekti është në cilësinë e funksionit drejtues, nuk mund të konsiderohet i papërshtatshëm si subjekt rivlerësimi në cilësinë e prokurorit... Në lidhje me procedimin penal nr. ***/2010, ... ku subjekti ka vepruar në cilësinë e prokurorit të çështjes, trupi gjykues, për shkak të mangësive të konstatuara në dosjen penale, ka vlerësuar se këto mangësi mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, gjykon se kjo dosje duhet t’i transferohet organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore [...] (f. 28 e vendimit).*

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, prokuror pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tiranë;
- Transferimin e çështjes me nr. *** akti, të vitit 2010, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c¹”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2², të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 4.12.2019, ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besim Hajdarmataj (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Objekti i këtij rekomandimi lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ për: (i) kriterin e aftësive profesionale; (ii) kriterin e pasurisë dhe (iii) vlerësimin në tërësi të çështjes. Si konkluzion, ONM-ja rekomandon që procesi i rivlerësimit për z. Hajdarmataj të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në përfundim, vendimi i Komisionit të ndryshohet, bazuar në vlerësimin si vijon:

II/A. Për kriterin e aftësive profesionale

6.1 Gjatë hetimit administrativ, pranë Komisionit dhe ONM-së, janë depozituar disa denoncime kundrejt subjektit të rivlerësimit. Ndër të tjera, këto denoncime referojnë pesë çështje penale të një rëndësie të lartë, të hetuara respektivisht nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, prokuroria e Kurbinit/Laç dhe ajo e Durrësit, kur në drejtimin e tyre ishte subjekti i rivlerësimit. Denoncuesit pretendojnë që rastet objekt denoncimi janë keqmenaxhuar me dashje nga subjekti, në këmbim të favoreve financiare. Ndërkohë që pretendimi për favore financiare mbetet për t’u provuar, është fakt që për çdo çështje të analizuar identifikohen të

¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankimi. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

² Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankimi. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

meta të konsiderueshme. Subjekti i rivlerësimit, herë në cilësinë e prokurorit të çështjes, që ka marrë në mënyrë direkte vendime përfundimtare, dhe herë si drejtues i prokurorisë, në të gjitha procedimet penale të analizuara, nuk ka ushtruar si duhet detyrat e tij funksionale në drejtim të këtyre çështjeve të rëndësishme, duke rezultuar kështu edhe në cenimin e besimit të publikut.

6.2 Në një vlerësim tërësor të të gjitha çështjeve të analizuara, Komisioni arriti në përfundime të bazuara, për të cilat i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e këtyre rezultateve, Komisioni konfirmoi në detyrë subjektin.

II. B. Për kriterin e pasurisë

6.3 Rezultatet e analizës financiare mbi burimet e ligjshme të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektivit të rivlerësimit, duke zbritur këtu shpenzimet minimale të jetesës, treguan që subjekti rezultoi me një balancë negative për vitet 2010 deri në vitin 2013, në një shumë totale prej 980.888 lekë.

6.4 Lidhur me vendbanimin e subjektivit të rivlerësimit. Në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar që të ketë në pronësi apo në përdorim pasuri të paluajtshme, ndërsa deklaroi si adresë vendbanimi, adresën: Njësia nr. ***, rruga “***.***”, pallati nr. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Bazuar në deklaratimet e subjektivit në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, kjo pronë i përket vëllezërve të tij, ***.*** dhe ***.***. Kontrata e porosisë së banesës (sipas së cilës banesa është blerë në çmimin 52.580 euro) është e nënshkruar vetëm nga vëllai ***.***. Subjekti në dukje jeton si i “ftuar” në këtë banesë bashkë me të ëmën, motrën dhe familjen e vëllait ***.***, ndërsa vëllai tjetër, ***.***, jeton në Mbretërinë e Bashkuar. Një ambient i tejmbushur, fakt i cili ngre dyshime.

6.5 Në përfundim të hetimit administrativ të Komisionit, mbeti e paprovuar në mënyrë bindëse mundësia financiare e krijimit të kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme.

6.6 Lidhur me shumat 6.000 euro dhe 4.000 GBP, deklaruar nga subjekti si dhurata nga vëllai ***.***, në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2007, 2008 dhe 2009, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se vëllai i tij kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme, për të dhuruar shumat respektive, si dhe nuk provoi mënyrën se si këto shuma erdhën në Shqipëri. Në konsideratë të faktit se, për të njëjtën periudhë, pretendohen shpenzime të tjera që ka bërë i njëjti vëllai në Shqipëri.

6.7 Përdorimi i makinës. Gjatë hetimit administrativ, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), informoi se shoqëria e sigurimeve “***” sh.a. kishte lëshuar në emër të subjektivit të rivlerësimit një policë sigurimi me periudhë mbulimi: datë ***.12.2010 deri më datë ***.12.2011, për një automjet në pronësi të ***.***. Lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 24.11.2018, nuk arriti të qartësonte raportin e tij me këtë automjet.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që

kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 200/2019, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe jo vetëm, për të cilat, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën, lidhur me: **(i)** procedimin penal nr. ***/2010, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kurbin; **(ii)** procedimin penal nr. ***/2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; **(iii)** procedimin penal nr. ***/2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; **(iv)** procedimin penal nr. ***/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; **(v)**³ procedimin penal me nr. ***/2012, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpallur moskompetenca tokësore dhe dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (drejtuesi i së cilës ka qenë subjekti); **(vi)** deklarin e pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar shpenzimet e deklaruara për vitet 2010-2013, në një diferencë negative totale prej - 980,888 lekë dhe **(vii)** çështje të tjera.

13. Në referencë të përmbajtjes të pikës 2, të nenit 4, të pikës 1, të nenit 59, dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

14. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A. Për vlerësimin e aftësive profesionale

15. Kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për qëllim të procesit të rivlerësimit, e gjejmë të rregulluar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës dhe për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit përfshihet aftësia për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësia organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërkohë, në nivel ligjor, referuar nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale fokusohet në vlerësimin e veprimtarisë etike të subjektit dhe atë profesionale, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016, i ndryshuar.

16. Në vështrim të sa më sipër, nga aktet në dosje të Komisionit, si dhe nga përmbajtja e vendimit nr. 200/2019, rezulton se pas mbylljes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 53 të

³ Barra e provës mbi çështjet e listuara nga pika (i) - (v) i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, pas hetimit administrativ shtesë.

ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit dhe ONM-së, janë depozituar disa denoncime nga publiku kundrejt subjektit të rivlerësimit. Si pasojë, trupi gjykues i Komisionit, i mbledhur në datën 9.4.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj.

17. Referuar rezultateve të hetimit administrativ shtesë, Komisioni ka konstatuar mangësi të shumta për kriterin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, të tilla që, për nga karakteri dhe përsëritja, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, kanë detyruar Komisionin t'i kalojë subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për çështjet si më poshtë⁴.

18. *Procedimi penal nr. ***, i vitit 2010, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, në të cilën subjekti ka pasur rolin e drejtuesit dhe prokurorit, i cili ka hetuar çështjen.*

18.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal, bazuar në një denoncim nga publiku, në të cilin pretendohet për kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona me precedentë kriminalë, dhe se subjekti i rivlerësimit ka ndikuar që kjo çështje penale të mos hetohej, me qëllim mbylljen e saj në favor të të dyshuarit kryesor, të njohurit të tij, shtetasit ***,***.

18.2 Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin ka informuar se: [...] *Pas verifikimit të regjistruar të procedimeve penale dhe kallëzimeve penale, rezulton se... Komisariati i Policisë Kurbin, më datë ***.5.2010, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, pa autor, për kryerjen e veprave penale "Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose shërbim publik" dhe "vetëgjyqësia", parashikuar nga nenet 235/1 e 277 të K. Penal. Pas hetimeve të kryera, me vendim të datës ***.7.2011, është vendosur pushimi i çështjes penale nr. ***/2010, të vitit 2010 [...], duke vënë në dispozicion dhe një kopje të fashikullit të këtij procedimi.*

18.3 Nga përmbajtja e akteve të procedimit penal nr. ***/2010, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se çështja është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të një zyrtari shtetëror, shtetas ***,***, drejtues i Zyrës së Njësisë së Mbikëqyrjes të Lojërave të Fatit (NJMLF), pranë Ministrisë së Financave. Referuar kallëzimit, ky shtetas, në ushtrim të detyrave të tij funksionale, kishte konfiskuar 5 makineri APEX, që përdorshin në mënyrë të jashtëligjshme për lojëra fati, në një lokal në qytetin e Peshkopisë.

18.4 Ndërkohë që makineritë e sekuestruara po transportoheshin për në Tiranë, drejtuesi/kallëzues së bashku me 4 kolegë të tjerë, janë ndaluar dhe kërcënuar seriozisht nga 13 - 15 persona, të cilët më pas i kanë marrë me forcë makineritë e konfiskuara. Mes tyre, kallëzuesi ka njohur shtetasit ***,***, ***,***, ***,***. Kallëzuesi ka pohuar se kërcënimet ndaj tij kanë vijuar atë ditë edhe gjatë rrugës për në Komisariatin e Policisë, ku është marrë dhe kërcënuar në telefon, në numrin e tij celular nga shtetasi ***,***. (duke dhënë dhe nr. e tij të telefonit).

18.5 Të gjithë zyrtarët e NJMLF-së, në dhënien e dëshmisë për rrethanat e ngjarjes, kanë deklaruar se kanë pasur kontakt pamor direkt me sulmuesit, si dhe kanë dëgjuar gjatë ngjarjes përdorimin e emrit të njërit prej tyre, shtetasit ***,***.

18.6 Pasi kanë bërë kallëzimin pranë Komisarariatit të Kurbin, punonjësit e NJMLF-së kanë vënë re një kamion, në të cilin ishin të ngarkuar 5 (pesë) makineri lojërash për fëmijë, të ndryshme nga makineritë e konfiskuara prej tyre në qytetin e Peshkopisë (të cilave kallëzuesi i kishte marrë dhe numrin e serisë sipas procesverbaleve përkatëse), duke referuar se ato ishin sjellë me qëllim stimulimin e situatës për pesë kompjuterat e konfiskuar prej tyre atë ditë.

⁴ Për këto çështje, Komisioni ka marrë mendim edhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe nga Prokuroria e Përgjithshme.

18.7 Për faktet dhe rrethanat e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes⁵, më datë ***.7.2011, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2010, duke arsyetuar se: [...] jemi përpara rasteve të pushimit të çështjes, pasi ka dyshime në ekzistencën e faktit, nuk provohet ekzistenca e faktit, i cili përbën vepër penale. Në nenin 328/1, germa “a”⁶ të K. Pr. Penale, parashikohet se ekzistenca e faktit është kusht për fillimin apo vazhdimin e procedimit penal. Në rastin konkret, pasi janë bërë hetime, nuk është bërë e mundur të provohet ekzistenca e faktit dhe, për këto arsye, procedimi penal nuk mund të vazhdojë më tej, por çështja duhet të pushohet [...].

18.8 Komisioni, pasi ka vlerësuar provat dhe shpjegimet e subjektit, ka konkluduar se [...] mangësitë e evidentuara në hetim dhe zvarritja e procesit hetimor janë të drejta. Në gjykim të rrethanave dhe fakteve, prokurori i çështjes nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të cilat do të ligjëronin vendimmarrjen e tij në prova dhe fakte konkrete se përse veprimi nuk përbënte vepër penale. Argumentimi i subjektit është i dobët, sepse ka shumë elemente dhe veprime hetimore të cilat duhet të ishin kryer [...] (f. 25-26 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vendosur transferimin e kësaj çështjeje, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

18.9 **Komisioneri Publik**, në analizë të fakteve dhe të rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, çmon se çështja nuk duhej të transferohej, pasi mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit janë aq të dukshme, sa ato, së bashku me vlerësimin tërësor të çështjes, mund të çojnë një vlerësim të ndryshëm për qëllim të procesit të rivlerësimit, pasi rezultoi se:

- (i) Duket sikur qëllimi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë hetimi në mënyrë shteruese i rastit, për sa kohë janë anashkaluar një sërë veprimesh procedurale të nevojshme hetimore në zbardhjen e çështjes dhe vënien para përgjegjësisë penale të aktorëve të përfshirë.
- (ii) Nga rrethanat e çështjes, do të ishte më e saktë që cilësimi i veprës dhe procedimi penal të regjistrohej për “Kundërshtim të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal. Provat ekzistuese kundrejt të dyshuarve për veprën penale ishin të bazuara dhe mundësonin lehtësisht marrjen e provave të tjera, për më tepër në kushtet kur vepra penale kishte një karakter dhe rrezikshmëri të tillë.
- (iii) Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, datë ***.5.2010, deri në momentin kur është vendosur pushimi i hetimeve në datën ***.7.2011, të vetmet veprime hetimore të kryera janë ato të Oficerit të Policisë Gjyqësore, në Komisariatit e Kurbinit. Për gati 1 vit e 3 muaj, nga ana e subjektit/Prokurorisë jo vetëm nuk është kryer hetim i thelluar, por nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të provuar konsumimin ose jo të veprës penale të regjistruar. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes, pa kryer asnjë veprim tjetër procedural, megjithëse provat dhe dëshmitë e administruara ishin të shumta për të mundësuar individualizimin e përgjegjësisë penale. Në vëmendje në këtë rast duhet pasur përcaktimi i nenit 73, pika 2⁷, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar.

⁵ Subjekti i rivlerësimit, në periudhën shkurt 2007 deri më shkurt 2013, ka ushtruar detyrën e drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbinit.

⁶ Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston.

⁷ “Aftësitë profesionale të prokurorit”... Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

- (iv) Nuk është thirrur për t'u pyetur shtetasi ***.***, emri i të cilit përmendet fillimisht në qytetin e Peshkopisë, ku ishin sekuestruar kompjuterat APEX dhe më pas, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga kallëzuesi, shtetasi ***.***, si dhe punonjësit e tjerë të NJMFL-së, që e shoqëronin. Si rrjedhojë, Prokuroria ka pasur mundësi që lehtësisht të thërriste personat në fjalë, në mënyrë që të bëhej njohja e personit të akuzuar, ***.***, dhe personave të tjerë, ***.*** dhe ***.***, si persona të cilët janë akuzuar se kanë kërcënuar punonjësit e shtetit.
- (v) Sa i përket stimulimit të referuar nga punonjësi i NJMFL-së, ngjarje e ndodhur po atë ditë pas kallëzimit, nuk është bërë asnjë veprim hetimor, në drejtim të identifikimit të shtetasit ***, i cili kishte porositur shtetasin***.*** të transportonte në Laç 5 kompjutera për fëmijë.
- (vi) Nuk është bërë përshkrim i plotë i kompjuterave të sekuestruar nga shtetasi ***.***, me qëllim identifikimin e tyre, megjithëse kallëzuesi, shtetasi ***.***, e përjashtonte kategorikisht faktin që këta kompjutera të ishin ata të konfiskuar prej tij në Peshkopi.
- (vii) Nuk rezulton nëse kallëzuesi ka marrë dijeni efektivisht për vendimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e hetimeve. Ndaj vendimit për pushimin e hetimeve nuk është ushtruar ankim. Gjithashtu, konstatojmë se vendimi i pushimit është marrë në datën ***.7.2011 dhe dosja është arkivuar në datën ***.11.2011. Ndërkohë, shkresa përcjellëse e vendimit të pushimit drejtuar NJMLF-së, Tiranë, është e datës ***.1.2013, pra rreth një vit e gjysmë pasi është vendosur pushimi i hetimeve.
- (viii) Subjekti, në shpjegimet e tij, vë në dyshim rrethanat e kallëzuara nga zyrtarët shtetërorë, arsyetim i cili nuk është bindës, pasi në këtë drejtim nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

18.10 Për mangësitë e vërejtura si më sipër, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, nuk arriti të provonte të kundërtën⁸, përkundrazi shpjegimet e tij i gjejmë të pabazuara.

18.11 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik e gjen të pambështetur vendimin e Komisionit për transferimin e çështjes nr. ***/2010, pranë organit kompetent, pasi rrethanat e dala nga vlerësimi i këtij rasti, në vështrim edhe me vlerësimin tërësor të çështjes, ka elemente të mjaftueshme për një vlerësim të ndryshëm, bazuar në përcaktimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

18.12 Kështu, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të *email*-it të datës 21.2.2019, kërkesës së Komisionit për të shpjeguar lidhjen me shtetasin ***.***, i është përgjigjur se: [...] *Sa i përket shtetasit ***.***, ju sqaroj se me këtë shtetas nuk kam asnjë lidhje, nuk kam ndonjë raport shoqëror dhe nuk kam pasur marrëdhënie familjare apo të tjera, thjesht e njoh si person [...].*

18.13 Ndërkohë, nga hetimi administrativ i Komisionit, kanë rezultuar rrethana dhe fakte që dëshmojnë të kundërtën, pasi, më datë ***.7.2017, ora 22:03, midis numrave telefonikë të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit ***.*** rezulton të jenë shkëmbyer mesazhe telefonike⁹, dhe se nga të dhënat e sistemit TIMS, rezultojnë kalime të përbashkëta të kufirit shqiptar përmes aeroportit të Rinasit, duke realizuar fluturime në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin destinacion, më shumë se një herë.

19. *Procedimi penal nr. ***, i vitit 2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit), e cila ka shpallur*

⁸ Në rapësimet e datës 4.10.2019, subjekti i rivlerësimit depozitoi në cilësinë e provës: (i) analizën vjetore të punës për vitin 2010, për të mbështetur argumentimin se ka pasur ngarkesë në punën e tij si drejtues dhe si prokuror; (ii) grafikun e gatishmërisë me nr. ***, datë ***.4.2010, sipas të cilës rezulton se subjekti në datën e regjistrimit të procedimit penal, ka qenë prokuror i gatshëm sipas grafikut.

⁹ Referohuni fashikullit “***”, në dosje të Komisionit.

moskompetencën lëndore, duke ia dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet

19.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal, bazuar në një denoncim nga publiku, në të cilin pretendohet se drejtuesi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka vendosur moskompetencën lëndore në shkëmbim të favoreve financiare, duke e dërguar çështjen për hetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, vend në të cilin, më datë ***.7.2017, ishin sekuestruar 11.650 kg lëndë narkotike *Cannabis sativa*.

19.2 Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr. *** prot. /***.***, datë ***.4.2019, ka informuar se: [...] *Procedimi penal nr. ***, viti 2017, është regjistruar më datë ***.4.2017, mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga Prokuroria pranë Shkallës së Parë, Përmet, për veprat penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim", në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", të parashikuar nga nenet 283/28, 333/a dhe 334/1 të K. Penal, në ngarkim të shtetasve ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***. Pas përfundimit të hetimeve është vendosur dërgimi për kompetencë, më datë ***.7.2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet. Pranë zyrës sonë nuk disponohen akte të kësaj dosje, për shkak se ato janë dorëzuar pranë Zyrës së regjistrimit dhe, sa më sipër, mund t'i drejtoheni Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet për administrimin e tyre [...].*

19.3 Nga verifikimi i akteve, ka rezultuar se në qytetin e Përmetit, në datën ***.4.2017, Policia e Shtetit ka gjetur dhe sekuestruar në një magazinë, pronë shtetërore, një sasi lëndë narkotike *Cannabis sativa*, me peshë totale 11.650 kg. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se personat e përfshirë si posedues të lëndës narkotike ishin katër shtetas, ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***. Në datën ***.4.2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet është bërë regjistrimi i procedimit penal me nr. ***, për veprën penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283/2, të Kodit Penal. Në datën ***.4.2017, prokurori i çështjes ka urdhëruar që në regjistër të shënohen veprat penale "Trafikim i narkotikëve", "Grupi i strukturuar kriminal", "Shpërdorim i detyrës", "Moskallëzimi i krimit", "Vjedhje e energjisë elektrike", parashikuar nga nenet 283/a/2/3, 333/a, 248, 300 dhe 137 të Kodit Penal. Është urdhëruar dhe regjistrimi i emrave të personave nën hetim ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve të procedimit penal nr. ***/2017, pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tiranë.

19.4 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, në datën ***.4.2017, aktet e procedimit penal nr. ***/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, ia ka kaluar për ndjekje të hetimeve prokurorit ***.***, i cili, në datën ***.4.2017, ka vendosur pranimin e akteve dhe regjistrimin penal nr. ***/2017, në ngarkim të shtetasve ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***, duke i cilësuar ndryshe pjesërisht veprat penale si: "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në formën e bashkëpunimit të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 283/28, 333/a, 334/1, të K. Penal.

19.5 Prokurori i çështjes, tre muaj më vonë, më datë ***.7.2017, pasi ka cilësuar në një shkallë më të ulët kategorizimin e veprave penale, duke përjashtuar ekzistencën e ndonjë lidhje me organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, ka vendosur të shpallë mungesën e kompetencës lëndore dhe të transferojë procedimin penal nr. ***/2017 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet.

19.6 Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit, ka qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga prokurori për transferimin e kësaj çështjeje. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, më datë ***.11.2017, ka dërguar për gjykim të pandehurit për

kryerje të veprës penale të “Moskallëzimit të krimin” dhe “Vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga nenet 300 dhe 137/2, të K. Penal.

19.7 Për rrethanat dhe faktet e mësipërme, fillimisht Komisioni ka vlerësuar se: [...] *vërehet se hetimi dhe vlerësimi i veprave penale të regjistruara në Prokurorinë e Krimeve të Rënda është përqendruar në të pandehurit që janë kapur në vendin e ngjarjes dhe nuk është kryer asnjë hetim në mënyrë që të evidentohet se kush ishin organizatorët e këtij aktiviteti. Mbledhja dhe paketimi i 11,650 kg kanabis, me vlerë të konsiderueshme, e cila kishte qenë në atë ambient për një periudhë të konsiderueshme kohe para se të kapej, ishte e dukshme që ishte për qëllim trafikimin ndërkombëtar të drogës dhe kërkonte një lloj organizimi, ku të përfshinte një numër të madh personash. Prokuroria për Krimet e Rënda nuk kishte kryer një hetim proaktiv për të identifikuar anëtarët e drejtuesit e grupit të strukturuar kriminal, të cilët po drejtonin një operacion shumë të madh të trafikut të lëndës narkotike [...]* (f. 18 e vendimit).

19.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të datës 4.10.2019, ka shpjeguar se: [...] *Për të mos rënë në përsëritje, edhe në këtë rast, është marrë parasysh ligji nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 02, datë 29.12.2016, “Për Organizimin dhe Koordinimin e Punës në Prokurori”. Ndërkohë ju shpjegoj se ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale ishin miratuar dhe hyrja në fuqi ishte çështje ditësh, por risqarojmë se kohë më parë kishte hyrë në fuqi ligji me nr. 97/2016. Me hyrjen në fuqi të ligjit me nr. 97/2016 ..., kompetencat e prokurorit më të lartë në ushtrimin e ndjekjes penale për çështje konkrete gjenin vend vetëm sa i përket fazës së hetimeve, ndërkohë që akoma nuk është marrë një vendim nga prokurori i çështjes. Edhe në fazën e hetimeve, udhëzimi i prokurorit më të lartë nuk është i detyrueshëm, ku edhe në këtë rast prokurori gëzon autonomi të plotë në orientimin e hetimeve [...]*.

19.9 Komisioni, në përfundim, ka konkluduar se: [...] *subjekti i rivlerësimit, si drejtues i Prokurorisë, është nënshkrues i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes së moskompetencës datë ***.7.2017, marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016 ... dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016 ... të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes. Në konsideratë të faktit se në vlerësimin drejt të situatës konkrete, ku roli i subjektit si drejtues nuk mund të ngarkohet apriori me elemente dyshimi të qëllimshme, trupi gjykues vlerëson se qëllimi duhet të provohet dhe jo të ngrihet mbi bazë hamendësimi [...]* (f. 19 e vendimit).

20. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, paragrafit 5, të nenit “E”, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016. Në vlerësimin tërësor të çështjes, fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, Komisioneri Publik çmon se ndryshimet e reja ligjore të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionin e prokurorisë në RSH”, nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të kompetencave udhëzuese të drejtuesit të Prokurorisë dhe nevojën e tyre, në rastin e veprave penale kaq sensitive. Për më tepër që për rastin në fjalë, kompetencat për të vepruar të drejtuesit të Prokurorisë, në raport me prokurorin e çështjes, gjenin ende zbatim në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (i kohës). Paqartësitë, mangësitë dhe mosveprimi në administrimin dhe hetimin e këtij rasti janë të dukshme, ku rezulton se:

20.1 Subjekti i rivlerësimit, posaçërisht për shkak të detyrës funksionale që ushtronte si drejtues i Prokurorisë, kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim kryerjen e veprimeve të

mëtejshme procedurale, përpara se nga prokurori i çështjes të merrej vendim mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake, bazuar në nenin 43¹⁰, të ligjit nr. 97/2016.

20.2 Për Komisionerin Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar me përgjegjshmëri detyrat e tij funksionale dhe mekanizmat që ligji i ka mundësuar për të mbikëqyrur ecurinë dhe përfundimin e çështjes. Shpjegimi i subjektit se, bazuar në ndryshimin e parashikimeve ligjore, në këtë rast shfaqet thjesht si nënshkrues i shkresës përcjellëse, nuk e justifikon aspak veprimin e tij.

20.3 Në rastin konkret, nuk evidentohet ndonjë komunikim i drejtuesit të Prokurorisë, subjektit të rivlerësimit me prokurorin e çështjes apo që subjekti të ketë udhëzuar me shkrim mbi ecurinë e rastit, pavarësisht faktit nëse këto udhëzime janë apo jo të detyrueshme për zbatim nga prokurori i çështjes. Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete mund të jepen kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit (*neni 48/3 i ligjit nr. 97/2016*).

20.4 Mosveprimi i subjektit në një çështje të përmasave të mëdha, ku bëhej fjalë për rreth 12 tonë bimë narkotike, të bën të mendosh se çfarë rëndësie duhet të ketë rasti që të reagojë një drejtues Prokurorie, të ushtrojë kompetencat që ligji ia njeh. Komisioneri Publik vlerëson se dhe në rastin më të mirë, pa dashur të ngarkojë subjektin me elemente dyshimi, sikurse është shprehur Komisioni, qëndrimi i subjektit dhe mosveprimi i tij duhet parë dhe vlerësuar në përputhje me parashikimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

21. *Procedimi penal nr. ***/2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit, prej marsit 2016), e cila ka shpallur moskompetencën lëndore dhe aktet ia ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër, ku janë zhvilluar hetime në procedimin penal me nr. ***/2017.*

21.1 Komisioni ka ardhur në dijëni të këtij procedimi penal, bazuar në një denoncim nga publiku, në të cilin pretendohet se subjekti ka vendosur zëvendësimin e prokurorit pa asnjë shkak dhe në mënyrë të paligjshme. Ka favorizuar të dyshuarit nën hetim dhe se me firmën e tij ka përcjellë çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër.

21.2 Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr. *** prot. /***.***, datë ***.4.2019, ka informuar se: [...] *Për sa i përket procedimit penal në ngarkim të shtetasit ***.***, ky shtetas është hetuar në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2013, të regjistruar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, më datë ***.11.2013, për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike", të mbetur në tentativë të parashikuar nga nenet 283/a/2/-22 të K. Penal. Me hetimin ... është caktuar prokurori ***.***. Me vendimin e datës ***.5.2017, të drejtuesit të Prokurorisë, Besim Hajdarmataj është bërë zëvendësimi i prokurorit ***.*** me një prokuror të caktuar me short... Nga procesverbali i shortit rezulton se është caktuar për hetim prokurori ***.***, ndërsa në regjistër dosja rezulton me emrat e dy prokurorëve (nuk disponojmë vendim të caktimit të dy prokurorëve) [...].*

21.3 Nga përmbajtja e akteve, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se (pasi ishte regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda, procedimi penal nr. ***/2013, për veprën penale të dyshuar, të parashikuar nga neni 283/a/2 i K. Penal), në datën ***.10.2014 dhe datën ***.9.2015, në Velipojë, shërbimet e policisë kufitare, në bashkëpunim me Guardia di Finanza

¹⁰ Drejtuesi i Prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: a) koordinon veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete; b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji; c) jep urdhra të detyrueshëm për Policinë Gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve; ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake; d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj; dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

kanë gjetur e sekuestruar çanta me lëndë narkotike *Cannabis sativa*, me peshë totale 780.5 kg. Veprimet hetimore janë konkretizuar me arrestimin e gjashtë shtetasve, të cilët janë dërguar për gjykim për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 238/a/2 e 22, të Kodit Penal. Ndërkohë për tre të tjerë, shtetasit ***,***, ***,*** dhe ***,***, më datë ***.10.2015, pasi ishin ndarë aktet, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka konkluduar se kanë konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 300, i K. Penal, “Moskallëzim i krimit”, duke ia kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër.

21.4 Në datë ***.5.2017, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit, ka vendosur të zëvendësojë prokurorin e çështjes ***,***, me shkakun e zvarritjes së hetimeve, mungesës së tyre për një periudhë njëvjeçare, faktit të krijimit të seksioneve që hetojnë grup-veprat të caktuara penale dhe ngarkesës në punë.

21.5 Në datën ***.5.2017, dy vjet pas regjistrimit të procedimit penal, janë regjistruar si persona nën hetim, të dyshuar për kryerjen e së njëjtës veprë penale për ngjarjen e mësipërme, shtetasit ***,***, ***,*** dhe ***,***. Në datën ***.5.2017, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pranuar kërkesat e prokurorëve, duke caktuar masat e sigurimit “Arrest në burg” për këta shtetas, për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”. Në datën ***.6.2017, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka shqyrtuar kërkesën e prokurorëve të çështjes me objekt verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit të caktuar ndaj shtetasit nën hetim ***,***. Me kërkesë të prokurorëve, me vendimin e datës ***.6.2017, Gjykata ka vendosur të zëvendësojë masën e sigurimit, nga arrest në burg, në detyrim paraqitje.

21.6 Më datë ***.7.2017, prokurorët ***,*** dhe ***,*** kanë vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër. Në përfundim, Gjykata e Shkallës së parë Shkodër, ka miratuar marrëveshjet e fajësisë për tre të pandehurit, ***,***, ***,*** dhe ***,***, për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”.

21.7 Për rrethanat dhe faktet e mësipërme, fillimisht Komisioni ka vlerësuar se: *[...] duke pasur parasysh rëndësinë tepër të madhe të çështjes në fjalë dhe sasinë e madhe të lëndës narkotike të gjetur, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e tij mbikëqyrëse të stafit, duke toleruar mosveprimin fillestar (që zgjati dy vjet), duke miratuar pas dy vitesh një kërkesë për caktimin e masës “arrest në burg” dhe duke miratuar transferimin e procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Shkodrës [...]* (f. 16 e vendimit).

21.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se, me miratimin e ligjeve paketë të reformës në drejtësi, është miratuar nga ligjvënësi ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Ndryshe nga ligji organik i mëparshëm, tashmë ligji i ri ka decentralizuar funksionimin e Prokurorisë nga shkalla hierarkike, duke kufizuar plotësisht kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale për çështje të veçanta. Subjekti ka argumentuar se ka zbatuar pavarësinë dhe autonominë e prokurorëve në zgjidhjet konkrete, ndërkohë që nuk ishte rasti kur prokurori më i lartë mund të ndërhyjë me asnjë udhëzim, ndërkohë që është marrë një vendimmarrje.

21.9 Komisioni, në përfundim, ka konkluduar se: *[...] subjekti i rivlerësimit, si drejtues i Prokurorisë, është nënshkrues i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes së moskompetencës marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016 ... dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, ... të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes, trupi gjykues ka çmuar se nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në funksionin e drejtuesit [...]* (f. 17 e vendimit).

22. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar

në nenin “E”, të aneksit të Kushtetutës, nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016. Në vlerësimin tërësor të çështjes, fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, Komisioneri Publik çmon se ndryshimet e reja ligjore të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionin e prokurorisë në RSH”, nuk duhen interpretuar në drejtim të mospërgjegjësisë, rolit mbështetës dhe mbikëqyrës të kompetencave udhëzuese të drejtuesit të Prokurorisë dhe nevojën e tyre, në rastin e veprave penale kaq sensitive. Për më tepër që për rastin në fjalë, kompetencat për të vepruar të drejtuesit të Prokurorisë në raport me prokurorin e çështjes gjenin ende zbatim në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (i kohës). Paqartësitë, mangësitë dhe mosveprimi në administrimin dhe hetimin e këtij rasti janë të dukshme, ku rezulton se:

22.1 Vendimi për zëvendësimin e prokurorit nga ana e subjektit të rivlerësimit është pjesërisht i argumentuar dhe i bazuar në ligj. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes me arsyetimin e organizimit të brendshëm të Prokurorisë nuk gjen mbështetje ligjore, referuar nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale.

22.2 Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është kryer asnjë lloj hetimi lidhur me nivelet më të larta të organizatës, duke përfshirë këtu dhe shtetasin ***.***, në periudhën pas konfiskimit të drogës, për afro dy vite. Ndërkohë gjatë gjithë kësaj periudhë nuk rezultoi e provuar që subjekti të ketë komunikuar me prokurorin e çështjes, të jetë përpjekur të informohet apo të adresojë problematikat.

22.3 Provohet fakti se subjekti i rivlerësimit në periudhën kohore nga marsi 2016 deri më 26 nëntor 2016, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2016, ka pasur kompetenca të plota veprimi mbi çështjen. Kompetenca këto të cilat ia njihte edhe Kodi i Procedurës Penale. Në cilësinë e drejtuesit, subjekti, vetëm pas një viti, ka vendosur të zëvendësojë prokurorin e ngarkuar, me argumentimin që ka konstatuar zvarritje të hetimeve dhe nevojën për ecurinë e tyre, megjithëse sikurse ka pranuar në parashtrimet e tij para Komisionit, ka qenë i vetëdijshëm për seriozitetin, problematikat dhe rëndësinë e çështjes.

22.4 Për sa më sipër, rezulton se edhe në këtë çështje të një rëndësie madhore, nisur nga sasia e madhe e lëndës narkotike, fakt ky i cili kërkon nivel organizimi të grupit të përfshirë, lidhjet e tyre me krimin e organizuar në shtetin fqinj, Itali etj., subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk ka ushtruar plotësisht detyrat e tij funksionale.

23. *Procedimi penal nr. ***/2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (për periudhën maj 2015 - mars 2016, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e zëvendësdrejtuesit e më pas atë të drejtuesit), dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, ku janë zhvilluar hetime në procedimin penal me nr. ***/2016*

23.1 Komisioni ka ardhur në dijëni të këtij procedimi penal, bazuar në një denoncim nga publiku, ku, ndër të tjera, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur moskompetencën duke e kaluar çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, me qëllimin e vetëm që dosja të mbyllet në këmbim të përfitimeve financiare.

23.2 Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr. *** prot./***.***, datë ***.4.2019, ka informuar se: “*Procedimi ***, viti 2015, është regjistruar më datë ***.9.2015, për nenet 283/2, 28/4, 334 dhe 333/a me 9 persona... në përfundim të hetimeve është vendosur dërgimi për kompetencë i procedimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, më datë ***.5.2016, për 8 persona, kurse për ***.*** është vendosur pushim hetimi më datë ***.3.2016*”.

23.3 Nga hetimi administrativ¹¹, për procedimin penal nr. ***/2015, në mënyrë të përmbledhur, ka rezultuar se referimi i veprës penale të dyshuar “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal është bërë sipas informacioneve të marra në rrugë operative, për një aktivitet kriminal që zhvillohej nga disa persona të përfshirë, prej qershorit

¹¹ Për më tepër, referohuni shkresës së KLP-së, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë ***.5.2019.

2015. Më pas, në një banesë private në Durrës është sekuestruar një sasi prej 668 kg e 337 gr *Cannabis sativa* dhe janë arrestuar në flagrancë personat e dyshuar.

23.4 Çështja i është caktuar prokurorit pranë Krimeve të Rënda, ***.***, i cili, në datën ***.9.2015, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale të dyshuar “trafikim i lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/a/2, i Kodit Penal. Hetimet ndaj personave të dyshuar kanë vazhduar në kuadër të kryerjes së veprave penale, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, më shumë se një herë, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal dhe “Kryerjes së veprave nga grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334, i Kodit Penal.

23.5 Pas disa muajsh, subjekti në cilësinë e drejtuesit, duke marrë drejtimin e çështjes penale, ka marrë vendimin përfundimtar, duke shpallur moskompetencën lëndore. Në marrjen e këtij vendimi, subjekti ka bërë klasifikim të ri (më të ulët) të veprës penale, duke përjashtuar ekzistencën e bashkëpunimit në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe nxjerrjen jashtë juridiksionit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Në datën ***.5.2016 është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe kalimi i akteve të procedimit penal nr. ***/2015, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, si Prokuroria që ka kompetencën lëndore dhe tokësore.

23.6 Rezulton se nuk ka vendim zëvendësimi të prokurorit ***.***, që ka ndjekur veprimet hetimore, nëse ai ka hequr dorë apo ka dhënë pëlqimin e tij, referuar dispozitave të K. Procedurës Penale. Megjithëse vendimi i shpalljes së moskompetencës është përpiluar nga Drejtuesi i Prokurorisë, nuk rezulton të ketë akt që argumenton arsyen, përse vendimi i është përpiluar prej tij.

23.7 Për rrethanat dhe faktet e mësipërme, fillimisht Komisioni ka vlerësuar se: [...] *duket se hetimet e kryera janë fokusuar vetëm te personat e kapur në flagrancë në vendngjarje. Nuk rezulton që të jenë kryer veprime të mëtejshme hetimore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për të verifikuar nëse ka pasur persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet. Nuk u arrit të zbardhej dhe të konkludohej se cili ishte destinacioni i sasisë së lëndës narkotike të gjetur që do të trafikohej [...]* (f. 20 e vendimit).

23.8 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka argumentuar se vendimi i tij për shpalljen e moskompetencës është mbështetur në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, të këtij kodi, ku parashikohej shprehimisht se prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët.

23.9 Komisioni, në përfundim ka konkluduar se: [...] *vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, në datën ***.5.2016, i përpiluar nga drejtuesi i Prokurorisë, z. B. Hajdarmataj, është hartuar nga ana formale në përputhje me ligjin procedural penal, bazuar në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohej shprehimisht se prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët. Vlerësimet dhe konstatimet e paraqitura nga Komisioni i referohen hetimeve shteruese që duhet të ishin kryer për këtë çështje, të cilat i përkasin prokurorit të çështjes [...]* (f. 22 e vendimit).

24. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, paragrafit 5, të nenit “E”, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016. Konstatohet, se sipas rastit, për çështjet që subjektit i ka kaluar barrë prove, subjekti jo gjithnjë mban në konsideratë nenin 25/2 të K. Pr. Penale, e sidomos në çështje sensitive, në të cilat hetimi administrativ i Komisionit tregoi se kanë pasur mangësi në hetimin e tyre. Ndërsa për rastin konkret, subjekti i referohet nenit 25/2 të K. Pr. Penale, për të justifikuar zëvendësimin pa asnjë akt formal të prokurorit të çështjes dhe vendimin e tij për shpalljen e moskompetencës. Për rastin konkret, rezulton se:

24.1 Për nga sasia e drogës së sekuestruar, personave të përfshirë, mangësive të konstatuara, nuk duket bindëse ndryshimi i cilësimit të veprave penale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nuk rezulton që të jenë dokumentuar hetime mbi lëvizjet financiare të të dyshuarve apo të jenë monitoruar telefonatat e tyre, me qëllim identifikimin e personave të tjerë të implikuar apo të konkludohej nëse rasti kishte karakter ndërkombëtar.

24.2 Fakti që gjykata dënoi të pandehurit për një vepër penale të një rrezikshmërie më të ulët, si “Prodhim dhe shitje e bimëve narkotike”, ashtu siç argumenton ndër të tjera dhe subjekti, nuk justifikon mungesën e hetimeve nga ana e Prokurorisë, pasi gjykatës nuk iu vunë në dispozicion asnjë element apo provë tjetër, në bazë të së cilës ajo mund të vendoste ndryshe.

24.3 Komisioneri Publik vlerëson se dhe në këtë rast qëndrimi dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, përveç se nuk janë bindëse dhe të mirëbazuara, ato duhen parë dhe vlerësuar me përcaktimet e ligjit nr. 96/2016.

25. *Procedimi penal nr. ***/2012, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Kjo e fundit ka shpallur moskompetencën tokësore, duke ia kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës (ku subjekti ka qenë drejtues, 2013-2015), regjistruar me nr. ***/2013.*

25.1 Komisioni ka ardhur në dijeni të këtij procedimi penal, bazuar në një denoncim nga publiku, ku, ndër të tjera, pretendohet se në këmbim të favoreve financiare, subjekti ka ndërhyrë në dosje pa asnjë akt ligjor të shkruar, qoftë dhe formal, duke hequr nga hetimi prokuroren e çështjes, ***.***, në kundërshtim me nenin 27, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ka vendosur në kundërshtim me ligjin moskompetencën, me arsyetimin e vetëm se Elbasani është rreth më i afërt me Tiranën se Durrësi. Ndërkohë që kishte më shumë se një vit që kishte pranuar kompetencën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

25.2 Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë aktet përkatëse të dosjes, duke dhënë dhe një vlerësim për këtë denoncim. Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2012, pas kallëzimit të shtetasit ***.***. Në datën ***.2.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar emrin e shtetasës ***.***. (gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), si të dyshuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, sipas nenit 248, të Kodit Penal.

25.3 Në datën ***.6.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencën për shkak të kushteve të parashikuara në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale dhe ka transferuar çështjen pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila më datë ***.7.2013, ka pranuar kompetencën, ka regjistruar çështjen dhe ka vijuar hetimin.

25.4 Në datën ***.11.2013, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, ka vendosur se: *“Nga analiza e akteve të këtij procedimi penal është konstatuar se autoriteti kompetent për vazhdimin e procedimit penal nuk ishte Prokuroria e Rrethit Durrës”,* duke nënshkruar vendimin e moskompetencës dhe transferimin e çështjes pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan.

25.5 Për rrethanat dhe faktet e mësipërme, fillimisht Komisioni ka vlerësuar se: *[...] arsyetimi për transferimin e çështjes është i dobët dhe nuk qartëson këndvështrimin se përse roli i shtetasit ***.*** do përbënte bazë për transferimin e çështjes, duke cituar arsyet e mundësisë (duke paragjykuar çështjen), argumente që nuk qëndrojnë ligjërisht. Në çdo rast, është e qartë se prokurorit të cilit i është ngarkuar çështja ishte znj. ***.***, e cila kishte kryer hetimin e çështjes dhe kishte planifikuar hapa të mëtejshëm hetimorë kur drejtuesi i Prokurorisë ndërhyri, duke urdhëruar transferimin e çështjes në një qytet tjetër. Në lidhje me arsyen e dytë të përmendur nga subjekti në vendim për transferimin e çështjes, se distanca e Tiranë - Elbasan është më e shkurtër se distanca Tiranë - Durrës, duket i paqartë ky argument i përdorur, sepse këtë fakt subjekti kishte mundësi që ta konstatonte që në momentin e regjistrimit të procedimit penal [...] (f. 24 e vendimit).*

25.6 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, të datës 4.10.2019, ndër të tjera, ka shpjeguar se, sa i përket argumentimit të shpalljes së moskompetencës të Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Durrës dhe kalimit të akteve, Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Elbasan, janë marrë parasysh parashikimet e nenit 78 të K. Pr. Penale, ndërsa baza ligjore e vendosur në vendimin e datës ***.11.2013 është një lapsus. Ndërkohë që analiza e shkaqeve të transferimit i referohet parashikimeve të nenit 78 të K. Pr. Penale, si një dispozitë e veçantë për punonjësit e drejtësisë (gjyqtar, prokuror). Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se në vendimin e shpalljes së moskompetencës kam argumentuar edhe pretendimin e kallëzuesit, se avokati i çështjes, i quajtur ***.***, kishte ndikuar në vendimmarrjen e gjyqtarit dhe se ky avokat ishte vëllai i prokurorit ***.***, në atë kohë zëvendësdrejtues i Prokurorisë, që mbulonte pikërisht seksionin e NJPH-së, ku ishte në hetim kjo çështje.

25.7 Komisioni, në përfundim ka konkluduar se: [...] subjekti i rivlerësimit, vendimin për shpalljen e moskompetencës, e ka mbështetur në ligjin referuar të drejtës funksionale, si drejtues i Prokurorisë për të ndërhyrë. Ai ka ushtruar kompetencat si prokuror më i lartë, në përputhje me parashikimet e nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me faktin që pretendimet e ngritura nga denoncuesi janë gjykuar edhe nga gjykatat më të larta që kanë marrë në shqyrtim çështjen, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë për të hyrë në themel të çështjes mbi atë që gjykatat më të larta kanë vendosur [...] (f. 25 e vendimit).

26. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016. Nga aktet e administruara rezulton se:

26.1 Subjekti i rivlerësimit, duke marrë çështjen nga prokurorja e ngarkuar, ***.***, dhe duke ndërmarrë vendimin final të shpalljes së moskompetencës, praktikisht ka ngarkuar veten si prokuror i çështjes, duke marrë përsipër hetimin dhe të metat e tij. Për më tepër, vlen të përmendet se nga subjekti në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nuk rezulton të jetë administruar vendim për zëvendësimin e prokurorit, gjë që bie ndesh dhe me vetë parashikimet ligjore të kohës mbi organizimin e prokurorisë dhe dispozitat e K. Pr. Penale.

26.2 Arsyetimi i subjektit është i paplotë dhe i paqartë, në drejtim të nevojës që çështja të trajtohej nga ana e tij, në kushtet kur tashmë hetimi kishte filluar dhe prokurorja ***.*** kishte përcaktuar ndërkohë dhe hapat e mëtejshëm për ecurinë e tyre.

26.3 Baza ligjore e referuar nga subjekti në arsyetimin e vendimit për transferimin e çështjes, me atë të dispozitivit, është e ndryshme, pasi është disponuar mbi bazën e nenit 76, në vend të nenit 78 të K. Pr. Penale. Por, edhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, sërish nuk jemi para rastit kur gjen zbatim neni 78 i K. Pr. Penale. Neni 78 mund të zbatohet vetëm kur gjyqtari/prokurori merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, ndërsa (në kundërshtim me këtë rast), subjekti e ka zbatuar këtë dispozitë duke iu referuar rastit të vëllait të një prokurori. Ky i fundit as nuk ka qenë i regjistruar si i dyshuar në momentin e marrjes së vendimit dhe as më pas.

26.4 Gjithashtu, argumentimi se Elbasani ishte më afër Tiranës se Durrësi, është jo bindës, i papajtueshëm me rrethanat dhe faktet, pasi në Prokurorinë e Durrësit janë transferuar plot raste të moskompetencës së Prokurorisë së Tiranës me bazë ligjore nenin 78 të K. Pr. Penale. Në mënyrë të pakuptimtë, ky arsyetim aplikohet në fazën përfundimtare të hetimit.

27. Në konkluzion për kriterin e aftësive profesionale, nga vlerësimi tërësor i fakteve dhe i rrethanave të analizuara më sipër, Komisioneri Publik konsideron se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e tij nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës. Për qëllim të vlerësimit të këtij kriteri, bazuar në parashikimet e nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016, konstatojmë se mangësitë e vërejtura janë të tilla që nuk justifikojnë dhe të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë. Neglizhenca dhe mosveprimi në cilësinë e drejtuesit, sikurse edhe në cilësinë e prokurorit, në çështjet penale me interes të

madh publik, duhet vlerësuar si cenim i besimit të publikut te drejtësia. Për pasojë, vendimi objekt ankimi duhet të rishikohet dhe të ndryshohet nga Kolegji dhe në referim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, ndaj subjektit të rivlerësimit, të gjejë zbatim masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

IV.B. Për vlerësimin e pasurisë

28. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

29. Subjekti i rivlerësimit, z. Hajdarmataj, në deklaratën “Vetting”, rezulton se ka deklaruar këto pasuri: (i) Depozita bankare: në shumën 5.000.000 lekë, në *** Bank; depozitë në shumën 1.000.000 lekë, në *** Bank; (ii) Llogari rrjedhëse e pagës me gjendje në shumën 995.704 lekë, në *** Bank; (iii) Gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë, me burim të ardhurat nga paga për periudhën 1.1.2016 - 31.12.2016 dhe (iv) Gjendje *cash* në shumat: 6.000 euro dhe 4.000 paund, me burim të deklaruar dhurata nga vëllai, me banim në Mbretërinë e Bashkuar, të dërguara në vitet 2007, 2008 dhe 2009.

30. Konstatohet se për gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, tej limitit ligjor prej 1.5 milionë lekë, të përcaktuar nga shtojca nr. 2, e ligjit nr. 84/2016.

31. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme financiare, përkatësisht për vitet 2010-2011-2012-2013, me një diferencë negative prej - 980,888 lekë.

31.1 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka kërkuar të rivlerësohen të dhënat e analizës financiare lidhur me: (i) të ardhurat nga bonusi i karburantit dhe (ii) shpenzimet e jetesës. Subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të Komisionit duhet të përfshihen shumat e kursyera nga të ardhurat e “bonusit të transportit”, pasi një pjesë e tyre janë shpenzuar duke u ndarë me kolegët. Subjekti ka kërkuar që analiza financiare të kryhej sipas standardit të ndjekur për të gjitha subjektet e rivlerësimit, bazuar në të dhënat e përcaktuara nga INSTAT-i, për minimum jetik apo shpenzimet jetike¹².

31.2 Komisioni, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, ka konkluduar se: [...] *Trupi gjykues ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit provoi mundësinë për të pasur këto likuiditete, pasi një pjesë e këtyre të ardhurave kanë arritur të kursehen nga subjekti, duke arritur në konkluzionin se trajtimi i bonusit të transportit duhet të llogaritet pjesërisht si e ardhur e subjektit për këto vite, si dhe për faktin se natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Trupi gjykues, në përfundim të analizës financiare të kryer për periudhën 2003 - 2016, pas analizës dhe arsyetimit të mësipërm, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme financiare për të*

¹² Referohuni shpjegimeve të subjektit nga rezultatet të hetimit. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës edhe dy deklarata noteriale: 1. Deklarata noteriale nr. ***, datë ***.4.2019, nga shtetasit, Besim Hajdarmataj, ***, ***, ***, ***, ku deklarohet se udhëtimi është kryer me automjetin në posedim të z.***.***, dhe shpenzimet janë ndarë në mënyrë proporcionale ndërmjet tyre; 2. Deklarata noteriale nr. ***, datë ***.4.2019, nga shtetasit Besim Hajdarmataj, ***, ***, ***, ***, dhe ***, ***, ku deklarohet se udhëtimet janë kryer me automjetin në pronësi të shtetasit ***, ***, të cilët kanë ndarë bashkë shpenzimet e transportit.

krijuar depozitat e deklaruara, kursimet cash dhe për të mbuluar shpenzimet [...] (f. 7 e vendimit).

31.3 **Komisioneri Publik** vlerëson se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ. Komisioneri Publik, në kuadër të vlerësimit të elementeve përbërëse të analizës financiare të Komisionit, vlerëson se në analizë nuk duheshin marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e rezultateve të hetimit dhe pretendimet e paraqitura vetëm pas kalimit të barrës së provës, lidhur me të ardhurat nga bonusi i karburantit dhe shpenzimet e jetesës. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shumat e përfituara nga bonusi i karburantit nuk duhej të ishin marrë në konsideratë, pasi dhe nën orientimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimi (JR) nr. 7/2019, vlerësojmë se, sikurse mbi trajtimin e dietave edhe bonusi i karburantit konsiderohet se ka mbuluar shpenzimet e transportit. Në të njëjtën logjikë, shpenzimet e transportit sipas deklarimeve të subjektit dhe të shoqëruar me deklarata noteriale nuk duhet të ishin llogaritur nga Komisioni. Komisioneri Publik çmon të nevojshme që Kolegji i Posaçëm i Apelit të mbajë një qëndrim të qartë rreth këtij shkak.

31.4 Lidhur me shpenzimet e jetesës, në vlerësimin e Komisionerit Publik, pretendimi i subjektit për rishikimin e shpenzimeve të llogaritura dhe krijimin e kursimeve nga kontributi i dekluar nga vetë ai, vetëm pas konstatimit nga ana e Komisionit të pamundësisë financiare për të krijuar kursimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore, mbetet i paprovuar dhe në kundërshtim me deklarinet e mëparshme të subjektit, për sa kohë vetë subjekti paraprakisht ka dekluar masën e kontributit mujor në familje në vlerën 25.000 - 30.000 lekë në muaj.

31.5 Po ashtu, Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve në dosje, konkretisht analizës financiare të paraqitur subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe analizës së arsyetuar në vendimin e Komisionit, konstaton se për disa vite nga ana e Komisionit janë rishikuar edhe shpenzimet e udhëtimit të subjektit, çka del dhe përtej pretendimeve të vetë subjektit.

31.6 Bazuar në sa argumentuar më sipër, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016, rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për një diferencë totale negative në vlerën – 1.145.121 lekë, e shtrirë për vitet 2010-2013¹³. Në këto kushte, Komisioneri Publik konsideron se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pasaktësisë dhe pamjaftueshmërisë së deklarinet të pasurisë, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” dhe neni 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

32. Banesa në përdorim

32.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk ka dekluar pasuri të paluajtshme në posedim apo përdorim. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore ka rezultuar se

¹³ Metodologjia e përdorur nga Komisioneri Publik në arritjen e këtij konkluzioni mbështetet në: (i) Të ardhurat e realizuara nga paga e subjektit janë llogaritur sipas vërtetimeve të paraqitura nga institucionet përgjegjëse, pa përfshirë këtu të ardhurat nga bonusi i karburantit, për arsyet e analizuara më sipër; (ii) Të ardhurat nga dhurimet nga vëllai ***.*** janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore (këto të ardhura do të trajtohen në vijim); (iii) Shpenzimet e jetesës, janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e datës 20.11.2018, si mesatare e thjeshtë aritmetike e vlerave të deklaruara nga vetë subjekti për kontributet mujore; (iv) Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur sipas metodologjisë së përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimet e mëparshme dhe mbështetur edhe në deklarinet e vetë subjektit, për kostot e udhëtimeve për periudhën që nga viti 2011. Në shpenzimet e udhëtimit nuk janë përfshirë shpenzimet e udhëtimeve të punës, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues; (v) Shpenzimet e qirasë dhe të mobilimit janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit; (vi) Në shpenzimet e subjektit janë llogaritur dhe shpenzimet për interesa të *overdraftit* (sipas verifikimeve të lëvizjeve të llogarive bankare të vëna në dispozicion); (vii) Kursimet në *cash* janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore; (viii) Ndryshimet e likuiditeteve në llogaritë bankare janë llogaritur sipas konfirmimeve të bankave të nivelit të dytë, për llogaritë e subjektit për periudhën 2003-2016.

subjekti ka ndryshuar disa herë adresën e banimit/qëndrimit. Komisioni ka hetuar lidhur me këtë fakt dhe, nga përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se subjekti nga maji i vitit 2009 e në vijim banon në adresën: Njësia Administrative nr. ***, rruga “***.***”, pallati nr. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Subjekti ka deklaruar se kjo adresë i përket shtëpisë së vëllezërve të tij, *** dhe ***.***.

32.2 Nga aktet në dosje rezulton se kjo pasuri është porositur me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., të datës ***.9.2007, nënshkruar midis shoqërisë “***” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasit ***.***, në cilësinë e porositësit¹⁴, për vlerën 52.580 euro, e cila sipas përcaktimeve të kontratës është shlyer plotësisht në momentin e hartimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

32.3 Për pasurinë e mësipërme, të cilën subjekti e deklaroi si adresë të tij banimi, Komisioni ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime dhe të paraqesë prova, për të evidentuar mundësinë financiare të vëllezërve të tij për blerjen e kësaj pasurie¹⁵. Subjekti ka deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer:

- (i) shuma prej 30.000 euro, dërguar nga vëllai ***.*** (emigrant në Mbretërinë e Bashkuar);
- (ii) shuma prej 1.000.000 lekë, dërguar po nga vëllai ***.***, për të mbuluar shpenzimet e mobilimit të apartamentit;
- (iii) diferenca prej 22.580 euro, investuar nga vëllai ***.***, me burime përkatësisht: 10.000 euro hua nga shtetasi ***.*** dhe pjesa tjetër, mbuluar nga kursimet personale;
- (iv) shuma prej 100.000 lekë, për mobilimin e dhomës në përdorim nga subjekti është mbuluar nga të ardhurat e vetë subjektit.

32.4 Subjekti ka paraqitur prova mbi të ardhurat e vëllait ***.***, nga puna në emigracion në Mbretërinë e Bashkuar, prova dhe dokumente mbi të ardhurat e vëllait ***.***, si dhe një deklaratë noteriale të datës ***.11.2018, hartuar dhe nënshkruar nga shtetasi ***.*** dhe ***.***, ku evidentohet huaja e marrë nga i vëllai ***.***, në vitin 2007 dhe kthimi i saj.

32.5 Për rrethanat dhe aktet e administruara si më sipër, rezulton se nuk kemi një vlerësim nga ana e Komisionit. Mbi bazën e këtyre akteve, Komisioneri Publik vlerëson se hetimi administrativ tregoi se:

32.5.1 Nuk provohet mundësia financiare e vëllait ***.***, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, përveç se nuk është në formën e kërkuar ligjore për vlefshmërinë dhe administrimin e tyre, sipas kërkesave të K. Pr. Civile, nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për të konfirmuar mundësinë financiare të vëllait për të përballuar një shpenzim të tillë;

32.5.2 Nuk provohet mënyra e transferimit të këtyre shumave në Shqipëri (30.000 euro dhe 1.000.000 lekë), si dhe nuk është bindës pretendimi dhe deklarimi i subjektit se këto shuma janë sjellë sa herë që i vëllai ka ardhur në Shqipëri. Nga të dhënat e sistemit TIMS, për periudhën që subjekti pretendon se kanë ardhur këto shuma, udhëtimet e të vëllait janë një hyrje-dalje në vitin 2006 dhe deri në momentin e blerjes së banesës (shtator 2007), nuk ka asnjë hyrje-dalje.

32.5.3 Nuk provohet mundësia financiare e vëllait ***.***, për të financuar shumën e deklaruar nga subjekti, sikurse nuk ka prova bindëse për të konfirmuar ekzistencën e huas, e marrë nga vëllai, shtetasi ***.***, si dhe mundësia financiare e tij për të shlyer huan deri në vitin 2012¹⁶.

32.6 Komisioni, pavarësisht fakteve për sa më sipër, ka arsyetuar se: [...] kur nuk rezultojnë nga aktet e administruara nga hetimi të dhëna apo dyshime që kjo pasuri është një pasuri e

¹⁴ Pasuria ende nuk është regjistruar në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit.

¹⁵ Referohuni pyetësorëve në dosjen e subjektit.

¹⁶ Komisioni ka kërkuar informacion nga ILDKPKI-ja lidhur me deklarinimin e interesave private të subjektit, ***.*** (duke qenë subjekt deklarues), nga e cila ka rezultuar se i vëllai i subjektit ka deklaruar të njëjtën pasuri me pjesë takuese 100%.

fshehur e subjektit të rivlerësimit, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, çmon se detyrimi i subjektit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, trupi gjykues vlerëson se shtrirja e hetimit edhe te pronat e familjarëve të tjerë nuk mund ta ngarkojnë subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar të mbajë si subjekt deklarues, pasi del jashtë qëllimit të ligjit [...] (f. 11 e vendimit).

32.7 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, çmon se vlera provuese e fakteve dhe e rrethanave të dala nga hetimi administrativ, të tilla si:

32.7.1 Vëllai ***.***, së bashku me familjarët e tij kanë qenë në një certifikatë familjare me subjektin e rivlerësimit deri në shtator të vitit 2016 (*banesa është blerë në vitin 2007*), vit në të cilin, nga aktet e vëna në dispozicion nga gjendja civile, rezultoi që subjekti ka kërkuar shkëputjen me argumentimin se jeton i vetëm;

32.7.2 Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij (*6 anëtarë*) jetojnë në të njëjtën banesë, në të cilën subjekti deklaroi se përdor një dhomë, të mobiluar me shpenzimet e tij;

32.7.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 (dorëzuar në datën 10.3.2010), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kursimet në *cash* në fillim të vitit 2009 dhe në fund të vitit 2009 kanë si burim të ardhurat nga paga e tij, paga e vëllait ***.*** dhe të ardhurat e dërguara nga vëllai ***.***. Kursimet në *cash* të akumuluar deri në datën 31.12.2016 (duke përfshirë dhe ato deri në vitin 2009) janë depozituar nga subjekti në depozitat bankare në emrin e tij dhe deklaruar në posedim në deklaratën “Vetting”;

32.7.4 Nga aktet rezultoi se në familjen e vëllait ***.***, vetëm ky shtetas është në marrëdhënie punësi, pa llogaritur këtu subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, diferenca negative në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit në kushtet e provuara të ekonomisë familjare do të thellohej dhe më tej;

32.7.5 Nga hetimi administrativ, sikurse deklaroi dhe subjekti, rezultoi se në të njëjtat vite në të cilat subjekti ka marrë në formën e dhuratës nga vëllai ***.*** (shumat 3.000 euro dhe 4.000 £), ky i fundit ka investuar dhe ka financuar për banesën, në vlerën prej 30.000 euro dhe 1.000.000 lekë, që do të trajtohen më gjerësisht në vijim.

32.8 Komisioneri Publik vlerëson se detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie nuk është në tejkalim të parashikimeve ligjore, përkundrazi është detyrim kushtetues dhe ligjor në kuadër të procesit të rivlerësimit. Po ashtu, sikurse dhe Kolegji ka konkluduar në vendimin (JR) nr. 8/2019, vetë dhënia e masave disiplinore është një masë proporcionale dhe ligjore, që lidhet me atë çfarë ka rezultuar nga gjykimi i çështjes dhe jepet në raport me verifikimin e shkaqeve të tilla si: deklarimi i pasaktë i pasurisë, fshehja e pasurisë, mungesa e burimit të ligjshëm për të justifikuar pasuritë etj. Për mënyrën se si ka vlerësuar dhe arsyetuar Komisioni, në analizë të fakteve dhe të rrethanave objektive të dala nga hetimi administrativ për këtë pasuri, nuk përjashton mundësinë e paraqitjes nga subjekti në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij dhe burimin real që ka shërbyer për krijimin e tyre.

32.9 Sa më sipër, vlerësojmë se vëllai ***.***, në kuptim të nenit 4, pika 13, të ligjit nr. 84/2016, merr cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Ndërsa, vëllai tjetër, ***.***, merr cilësinë e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të shumave të dhëna si dhurata subjektit të rivlerësimit.

33. Kursime në *cash* në shumat 6.000 euro dhe 4.000 paund

33.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se posedon kursime në *cash* në shumat 6.000 euro dhe 4.000 paund. Si burim krijimi për këto kursime, subjekti ka deklaruar se janë dhurata të marra nga i vëllai.

33.2 Në DV- 2007, subjekti ka deklaruar si shtim të pasurisë shumën 3.000 euro, me burim nga vëllai ***.***, të ardhura nga Anglia, të pashoqëruara me dokumentacion në rrugë

private. Në DV-2008, subjekti ka deklaruar si shtim të pasurisë shumë 4.000 paund, me burim nga vëllai ***.***. Në DV-2009, subjekti ka deklaruar si shtim të pasurisë shumë 3.000 euro, me burim nga vëllai ***.***.

33.3 Komisioni, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit sqarime lidhur me arsyet e këtyre dhurimeve, mënyrën e dhënies së tyre, prova të transferimit të këtyre likuiditeteve të subjekti i rivlerësimit, si dhe shpjegime dhe prova mbi mundësitë financiare të shtetasit ***.***, për të dhënë këto shuma¹⁷.

33.4 Në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, subjekti ka deklaruar se këto shuma janë dhuruar si rezultat i përkujdesjes së tij ndaj familjarëve dhe janë sjellë nga vëllai ***.***, dorazi gjatë viteve të deklarimit. Subjekti ka deklaruar se i vëllai ka jetuar dhe punuar si emigrant i ligjshëm në Mbretërinë e Bashkuar prej vitit 2005, e në vijim dhe ka paraqitur disa dokumente për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të tij, për periudhën 2006-2009. Për të provuar dhurimet, subjekti ka paraqitur dhe një deklaratë noteriale të nënshkruar nga i vëllai, shtetasi ***.***, në datën ***.1.2017, në të cilën ky shtetas konfirmon dhurimet sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

33.5 Në vlerësim të shpjegimeve dhe të provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni ka arsyetuar se: *[...] nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se vëllai i subjektit ka hyrje-dalje që prej vitit 2006 e në vijim, referuar dhe fotokopjes së pasaportës të vënë në dispozicion nga subjekti për periudhën 2006 - 2009. Trupi gjykues arrin në përfundimin se dokumentacioni ligjor i paraqitur nga subjekti është i plotë dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi... Lidhur me ligjshmërinë e tyre, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar sa më sipër, vlerëson dhe provon se të ardhurat për periudhën 2006 - 2009 janë në vlerën 26.106 paund, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të masës së të ardhurave të dhuruara nga vëllai i tij, në raport edhe me shpenzimet jetike [...].*

33.6 **Komisioneri Publik**, në analizë të akteve dhe të provave të administruara, vlerëson se:

33.6.1 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë financiare të vëllait ***.***, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumat e deklaruara si të dhuruara gjatë viteve 2006-2009, duke konsideruar këtu dhe sa është analizuar më sipër, në paragrafin 32.5.1, mbi investimet e vëllait në të njëjtat vite, për blerjen dhe mobilimin e banesës (për vlerën 30.000 euro dhe 1.000.000 lekë).

33.6.2 Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait ***.***, nuk është në formën e kërkuar ligjore për vlefshmërinë dhe administrimin e tyre, sipas kërkesave të K. Pr. Civile.

33.6.3 Dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk mbulon të gjithë periudhën e analizuar dhe nuk pasqyron në mënyrë të plotë të ardhurat e vëllait, me qëllim vlerësimin e tyre sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës.

33.7 Komisioneri Publik, si konkluzion për sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarinë të saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar pasurinë, pasi nuk provohet me dokumentacion ligjor në kuadër të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, aftësia e personit tjetër të lidhur që me të ardhura nga burime të ligjshme, t'i dhuronte subjektit, shumat 6.000 euro dhe 4.000 paund, të deklaruara nga subjekti si kursime *cash* në deklaratën “Vetting”.

V. Çështje të tjera

34. Përdorimi i makinës/kontaktet

34.1 Gjatë hetimit administrativ, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), me shkresën nr. ***, datë ***.11.2018, ka informuar Komisionin se shoqëria “***” sh.a. ka lëshuar në emër

¹⁷ Referohuni pyetësorit të datës 24.10.2018 dhe përgjigjeve të subjektit.

të subjektit të rivlerësimit policën e sigurimit TPL, me numër serie ***, për një periudhë mbulimi: datë ***.12.2010 - datë ***.12.2011. Kjo policë sigurimi ishte lëshuar për një automjet tip “Audi A4”, në pronësi të shtetasës ***.***, me përdorues z. Besim Hajdarmataj.

34.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 24.11.2018, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Nuk më rezulton të kem dijeni rreth këtyre siguracioneve dhe po ashtu s’kam dijeni për automjetet në fjalë. Nuk jam paraqitur ndonjëherë pranë ndonjë kompanie sigurimi për të paguar ose kërkuar siguracione sipas këtyre të dhënave të mësipërme. Unë nuk njoh asnjërin nga personat të cilët paraqiten si pronarë të këtyre automjeteve”*. Ndërsa në përgjigje të email-it të datës 12.12.2018, në përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Jam shumë i surprizuar në lidhje me policën e sigurimit për vitin 2010 - 2011, ku ndodhet dhe emri i vëllait tim ***. I kam kërkuar shpjegime vëllait tim lidhur me këtë fakt dhe më ka sqaruar se: “E kam paguar unë këtë policë, por nuk ju kam bërë me dije, pasi nuk e kam vlerësuar këtë fakt”*.

34.3 DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2018, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka informuar se nga verifikimet e bëra në sistemin informatik ka rezultuar se automjeti tip “Audi”, me ngjyrë të zezë me nr. shasie ***, nuk figuron i regjistruar në DPSHTRR. Po ashtu ka informuar se shtetësja ***.*** nuk ka automjete të regjistruara pranë DPSHTRR-së.

34.4 Në vështrim të vlerësimit tërësor të çështjes, nisur nga denoncimet e publikut, Komisioni ka ardhur në dijeni të kontakteve të subjektit me persona me precedentë penalë, si dhe të faktit se ka udhëtuar me ta dhe me makinat e tyre. Në këtë drejtim, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi ndryshe nga faktet e administruara, pretendon se nuk ka asnjë njohje me ta. Por, sikurse rezultoi dhe në rastin me shtetasin ***.*** (rasti i Kurbinit), ku subjekti kishte kontakte telefonike dhe udhëtime, rezulton e provuar se subjekti ka udhëtuar edhe me shtetasin ***.*** dhe ***.***, të dy të proceduar penalisht.

34.5 Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha rrethanat e mësipërme mbartin në vete dyshimin e arsyeshëm për kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona me precedentë penalë, fakt i cili duhet çmuar në vlerësimin tërësor të çështjes, si dhe në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

VI. Kërkimi i ankimit

35. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

36. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

37. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

38. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-34, 40-44, nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

39. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Besim Hajdarmataj.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i ONM-së, nr. 623 prot., datë 4.12.2019.